



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**6 nëntor 2017, Prishtinë,
Ref:12.07.2017\578-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së KEDS-it kundër portalit GazetaFjala**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e KEDS-it kundër portalit GazetaFjala lidhur me artikujt "KEDS-it i ik drejtori i prokurimit" i datës 12.07.2017, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet pjesërisht

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se në artikullin me titull "KEDS-it i ik drejtori i prokurimit" publikuar më datë 12.07.2017, për "dyshime për ngacmim seksual" gjë që nuk është e vërtetë.

Në ankesë gjithashtu thuhet se në raportin e policisë së Kosovës qëndron që viktimë e sulmit ka qenë drejtori i rrjetit të KEDS-it Mehmet Koç. Policia ka konfirmuar që Mehmet Koç ka qenë vikimë e një sulmi fizik dhe asnjëher, sipas policisë shkak sulmi nuk ka qenë ndonjë ngacmim seksual siç pretendon portali GazetaFjala.

Në ankesë pranohet se kjo gazetë e ka dërguar pyetjen rreth kësaj çështje, por nuk i është dhënë kohë KEDS-it të përgjigjet meqë e kanë publikuar shkrimin brenda ditës pa e pritur fare përgjigjen.

Bordi i KMSHK konstatoi se ka shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, meqë Mehmet Koç nuk ishte i dyshuar për përfshirje në një ngacmim seksual.

Vendimi u mor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës